



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjenë Më/Dana 12-10-2022			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Eroj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednos'
09-320/04-36562			



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Vitina

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë, pas shqyrtimit të kërkesës për shfrytëzim e hapësirës publike para kafeterisë në rrugën “Rruga UÇK-së” në Viti, nr. protokollit 09-320/04-36562, të datës 23.08.2022, Reuf Emerllahu nga fshati Verban të Komunës së Vitisë me numër të letërnjoftimit 1231677620, bazë nenit 26, 27 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative me Nr.05/L-031, lidhur me nenit 4, pika 2, shkronja b, të Rregullores Komunale për Vendosje dhe largim të Objekteve të Përkohshme në Pronë Publike me nr. 02-013/372, të datës 31.03.2016 dhe nenit 12.1.4 të Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha me Nr.01-0-110/05-731, të datës 24.09.2021, nxjerr këtë:

## LEJE TË PËRKOHSHME PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE

**I. I LEJOHET** Reaf Emerllahut, si menaxher i biznesit “Emporium Lounge Bar Resto” SHPK me Nr. biz. 811969768, shfrytëzimi i hapësirës publike me rrethoja xhami **me kuotë 0.00 të jet Ha. 00-1.7m**, hapësirë që gjendet para objektit hotelier për tavolina gjatë sezonit veror dhe dimërorë, e dedikuar për ofrimin shërbimeve për klient të lokalit të Kafetarisë “Emporium Lounge Bar Resto” SHPK në rrugën “Hoxhë Januzi” në Viti. Shfrytëzuesit të hapësirës publike nuk i lejohet ndërtimi i vrazhdë me material ndërtimor dhe kjo hapësirë publike duhet të lirohet nëse Komuna ka interes për këtë hapësirë.

**II.** Pala mundë ta shfrytëzojë hapësirën publike nga data 12.10.2022 deri më 12.10.2023, 1 (një) vjeçar.

Dimensionet: **8.00 m X 10.9m = 87m<sup>2</sup>** , **87m<sup>2</sup> X 2€/m<sup>2</sup>/muaj = 174 €/muaj**  
**174 X 12 muaj = 2.088€**

**III.** Kompensimi për shfrytëzimin e hapësirës publike të cekur më lartë bëhet në harmoni me Rregulloren Komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoha me Nr.01-110/05-731, të dt.24.9.2021 të miratuar nga Kuvendi Komunal në Viti.

**IV.** Shfrytëzimi i kësaj leje duhet t’i përmbahet kufizimit të shfrytëzimit të hapësirës publike të lejuar, në mënyrë që nuk të pengohet trotuari në dy rrugët (“Hoxhe Jonuzi” dhe “Rruga UÇK-së”), lëvizja e lirë e qytetarëve si dhe kufizimit të zhurmës (dispozita këto të cilat janë të parapara me Ligjin për Mbrojtjen nga Zhurma).

**V.** Paga bëhet në xhirollogarinë e Buxhetit Komunal me aktin e tërheqjes së kësaj leje.

**Vërejtje:** Pas skadimit të afatit të caktuar, shfrytëzuesi i hapësirës publike është i detyruar të bëjë kërkesë të re për vazhdimin e lejes. Në të kundërtën duhet të lirohet hapësira që është dhënë në shfrytëzim dhe ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme.

Viti, më datën 12.10.2022

Zyrtar Ligjor:

  
/Driton Halabaku/

Leja i dërgohet:

- 1.Palës
- 2.D.SH.P.E
- 3 D. Inspektoriatit
- 4.Arkivit

Drejtori

  
/Basri Aliu/

